

I. Organizata "QATAR CHARITY" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson drejtori i saj
z. Mahmoud Shaker (pala e parë) :

II. Komuna e Vushtrrisë , të cilën e përfaqëson kryetari i komunës z. Xhafer Tahiri (pala e dytë).

Me datën 31.07.2018, lidhën këtë :

Marrëveshje Bashkëpunimi

Neni 1.

Organizata Qatar Charity e regjistruar me nrb: 5300556-0 të cilën e përfaqëson drejtori z. Mahmoud Shaker, merret me ndihmën e fëmijëve jetim , për momentin në organizatë janë të regjistruar 3000 jetim/e që marrin ndihmë financiare mujore.

Neni 2.

Me qëllim përmirësimi të gjendjes ekonomike të fëmijëve pa prind, palët e lartpërmendura lidhën marrëveshje bashkëpunimi që të na ndihmojë në punën tonë duke na ofruar listën me emra të fëmijëve jetim.

Neni 3.

Lista i dërgohet organizatës në mënyrë mujore me këto kushte:

- Jetimi/ja **jo më të mëdhenj se 12 vite** (për këtë vit jetimi/ja që janë të lindur nga 2006 – 2018)
- Jetimi/ja **duhet të jenë pa prindin (që i ka vdekur baba)** apo pa të dy prindërit – ky kusht është shkaku i politikave të organizatës Qatar Charity.

Neni 3.

Lista në fjalë duhet të ketë emrin edhe mbiemrin e jetimit/ës, adresën dhe numrin e kontaktues të familjes, lista do të përdoret vetëm për të kontaktuar familjet dhe për të informuar që të aplikojnë tek ne.

Neni 4.

Jetimi/ja do të përfitojnë ndihmë financiare e cila do të zgjas deri kur jetimi/ja ti mbush 18 vite, nëse jetimi/ja ka sukses të shkëlqyer atëherë e njëjta ndihmë i vazhdohet deri në përfundimin e studimeve, gjithashtu përfiton edhe nga projektet e ndryshme (veshmbathje për festa, veshmbathje shkollore, pako ushqimore, mjete shkollore, kujdes shëndetësor, avancim profesional, dru për nxehje, shtëpi, etj).



قطر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo Office

Neni 5.

Komuna e **Vushtrrisë** zotohet se përmes mekanizmave të saj do të ofron mbështetje teknike në zhvillimin e suksesshëm të këtyre projekteve.

Neni 6.

Komuna e **Vushtrrisë** zotohet se do të përdorë çdo masë të nevojshme që të bëhet senzibilizimi i nevojshëm, si: **Zyra për informim, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Shëndetësi, Drejtoria për Administratë** (të njoftohen kryetarët e fshatrave) dhe në çdo formë tjetër që komuna vlerëson si të nevojshëm dhe të mundshëm.

Neni 7.

Kjo marrëveshje vlen nga data e nënshkrimit dhe është e hapur.

Drejtor i organizatës “Qatar Charity”
z. Mahmoud Abbas Shaker

قطر الخيرية
Qatar Charity
Kosovo Office



Kryetari i komunës
z. Xhafer Tahiri

KËRKESE

Datë:	31.07.2018
Nr i Referencës:	1/10/99
Për:	Kryetarin e Komunës së Vushtrrisë z. Xhafer TAHIRI
Nga:	z. Mahmoud Abbas SHAKER , Drejtor i organizatës “Qatar Charity”
Tema:	Kërkesë për bashkëpunim

Organizata Qatar Charity e regjistruar me nrb: 5300556-0 të cilën e përfaqson drejtori z.Mahmoud

Shaker, që nga paslufta mirret me ndihmen e femijëve jetim ku i kemi te regjistruar mbi 3000 femijë që mbështetën nga kjo organizatë.

Duke parë përkushtimin që tregoni për shoqërinë e komunës suaj, në avancimin dhe përkrahjen e shtresave nevojtare, jemi të gatshëm të ju ofrojmë bashkëpunim për realizimin e këtyre objektivave.

Andaj, kemi nderin t'iu shprehim bashkëpunim për përkrahjen e shtresës me të ndjeshme të shoqërisë, jetimët e komunës suaj.

Kësaj kërkesë iu bashkëngjitet draft-marrëveshja për bashkëpunim nga ana jonë.

Me shpresë se do të hasim në mirëkuptimin tuaj.

Organizata “Qatar Charity”
Drejtor, z. Mahmoud Abbas Shaker

